



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

HARTA RRUGORE E ASK-së PËR VITIN 2020

Dhjetor, 2019
Prishtinë

PARATHËNIE

Ky dokument përmban planin e veprimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe është i bazuar në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare për vitin 2020 të ASK-së, si dhe në Programin e Statistikave Zyrtare 2018-2022, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës.

ASK-ja gjatë vitit 2020 do të jetë e fokusuar në: zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022; zbatimin e Planit Vjetor të Statistikave Zyrtare 2020; zbatimin e Planit të Veprimit për realizimin e rekomandimeve të Raportit “Peer Review 2017”; avancimin e sistemit të planifikimit dhe të monitorimit përmes Sistemit të SIPK-ut; zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore, të rregulloreve ekzistuese dhe ato që priten të aprovohen; ngritjen e kapaciteteve në ASK, posaçërisht në statistikat sociale, fushën e llogarive kombëtare, statistikat ekonomike, statistikat e bujqësisë, në TI dhe në mbledhjen e të dhënave.

Në këtë dokument janë paraqitur aktivitetet më të rëndësishme të ASK-së, që janë të bazuara në planet dhe detyrat e rregullta, të paraqitura në formë të proceseve rrugore të integruara. Përderisa, planet më të detajuara* ekzistojnë në dokumentet e brendshme të departamenteve përkatëse të ASK-së.

Në pjesën e parë të vitit 2020, sipas obligimeve nga Ligji për Statistikat Zyrtare, ASK-ja do ta përgatisë Raportin Vjetor, ku do të përfshihet performanca e departamenteve, respektivisht arritjet në ASK dhe në Sistemin Statistikor të Kosovës gjatë vitit 2019. Dallimet eventuale, ndërmjet asaj që është planifikuar dhe asaj që është realizuar, barten si pjesë e planit për vitin vijues. Sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare të Kosovës, Raporti Vjetor dërgohet në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës për miratim.

* Planet e detajuara nënkuptojnë dokumentet, që i kanë departamentet përkatëse, të cilat cilësohen si “fletë punuese”.

PËRMBAJTJE

Faqe

1. ORGANIZIMI I ASK-së.....	4
1.1 Aktivitete të rëndësishme, që priten të finalizohen në 2020.....	4
2. KËSHILLI STATISTIKOR	5
3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2020.....	5
3.1 Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim.....	6
3.2 Departamenti i Llogarive Kombëtare	6
3.3 Departamenti i Statistikave Ekonomike.....	8
3.4 Departamenti i Statistikave Sociale	10
3.5 Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.....	16
3.6 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative	17
3.7 Departamenti i Anketimeve dhe Regjistrimeve	20
3.8 Departamenti i Administratës.....	20
4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORËT	21
5. SFIDAT	23
6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE DHE QASJA.....	23
7. BUXHETI	27
Aneksi 1 - Organogrami i ASK-së.....	28

1. ORGANIZIMI I ASK-së

Me qëllim të plotësimit të nevojave të përdoruesve me të dhëna statistikore të sakta, të besueshme, në kohë dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht, ASK-ja gjatë vitit 2020 do të vazhdoj të rrisë kapacitetet njerëzore dhe profesionale.

Sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare, Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022, Planit të Veprimit për realizimin e rekomandimeve nga Raporti “Peer Review”, MSA-së, PKZMSA, ERA, etj, ASK-ja ka obligime dhe përgjegjësi të mëdha në ngritjen edhe zhvillimin e statistikave zyrtare në nivel vendi, në harmoni me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare statistikore duke përfshirë edhe legjislacionin sekondar.

ASK-ja do të kryej edhe detyra për çështje të tjera, që parashihen me Ligj dhe me aktet nënligjore.

Gjatë vitit 2020 ASK-ja planifikon:

- Përcaktimin dhe zhvillimin e metodologjisë statistikore, klasifikimin dhe përdorimin e standardeve ndërkombëtare për prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare;
- Hartimi dhe dërgimin e planit vjetor të punës për vitin 2021 në qeveri për aprovim;
- Ta paraqesë për miratim Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, Raportin Vjetor 2019 mbi zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Raporti vjetor i miratuar do të publikohet;
- Fuqizimin e bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, kompetente për statistikave zyrtare, me qëllim që të mundësohet krahasimi i statistikave zyrtare të Kosovës me statistikave të prodhuara në sisteme të tjera statistikore;
- Të rrisë sasinë dhe cilësinë e statistikave zyrtare përfshirë modernizimin e proceseve për mbledhjen e të dhënave statistikore;
- Rritjen e koordinimit dhe komunikimit në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës, sidomos tek indikatorët SDG.

1.1 Aktivitete të rëndësishme, që priten të finalizohen në 2020

- Aktivitete që kanë të bëjnë me realizimin e Projektit të Regjistrimit të Popullsisë 2021, përkatësisht realizimi i Pilot-Regjistrimit të Popullsisë në vitin 2020, kjo varësisht nga mbështetja nga Qeveria edhe Kuvendi i Kosovës;
- Rritja e kapaciteteve profesionale në ASK dhe fuqizimi i statistikave sociale, llogarive kombëtare, ekonomike, të bujqësisë dhe sistemeve të TI-së;

- Prodhimi i statistikave sipas standardeve evropiane dhe botërore dhe zgjerimi i volumit të tyre. Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare, zbatimi i metodologjisë statistikore evropiane;
- Avancimi dhe zbatimi i Kornizës së Vlerësimit të Performancës (Projekti i SIPK-ut);
- Avancimi i prodhimit të statistikave tremujore të BPV-së dhe statistikave tremujore të Tregut të Punës;
- Publikimi për herë të parë i të dhënave nga ekonomia e pavrojtuar, si dhe publikimi i statistikave mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC);
- Rritja e buxhetit të nevojshëm nga buxheti i Kosovës, për vitin 2021;
- Draftimin dhe dërgimin në Qeveri për aprovim të dy udhëzimeve administrative (Draft UA, për të dhënat statistikore konfidenciale dhe draft UA për shitjen e të dhënave statistikore) në përputhje me Ligjin e Statistikave Zyrtare dhe plotësim ndryshimin e tij;
- Draftimi i Projektligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe banesave, 2021;
- Zbatimin e Pilot projektit për Regjistrimin e Popullsisë 2021;
- Zbatimin e projektit katërvjeçar me KE dhe SIDA-n suedeze, MICS6 me UNICEF-in, etj.

2. KËSHILLI STATISTIKOR

Këshilli përbëhet nga dymbëdhjetë (12) anëtarë dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, që përfaqësojnë institucionet kyçe, universitetet, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile. Këshilli i Ri Statistikor që është formuar me Vendim të Qeverisë së Kosovës gjatë vitit 2019 me mandat 5 vjeçar, sipas Rregullores për funksionimin e tij, do të jep rekomandime lidhur me proceset e zhvillimit të statistikave zyrtare. Takimet e rregullta mbahen në çdo tre muaj.

3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2020

Një ndër qëllimet e ASK-së është ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale me qëllim të prodhimit të statistikave zyrtare sipas standardeve dhe metodologjive të kërkuara nga Eurostat. Ky zhvillim i departamenteve do të bëhet në pajtim me planin zhvillimor të ASK-së si dhe politikave të diseminimit për: rritjen numrit dhe cilësisë së statistikave zyrtare; evitimin e të gjitha gabimeve të mundshme në publikimet e ASK-së; zhvillimin e mëtejshëm të metodologjive dhe teknologjisë statistikore; zhvillimin e politikave të standardizimit dhe mbështetjen në përvojat e fituara me ekspertë ndërkombëtarë për zbatimin e këtyre standardeve.

Më poshtë janë dhënë proceset rrugore sipas departamenteve për vitin 2020.

3.1 Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit janë të përshkruara në Rregulloren për Riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Përgjegjësitë kryesore të DPPKK, konsistojnë në procesin e planifikimit, monitorimit dhe koordinimit të aktiviteteve si brenda dhe jashtë ASK-së. Hartimi dhe zbatimin politikave në fushën e statistikave, përmirësimi dhe avancimi i bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, në veçanti me Eurostat, koordinimi (brenda ASK-së dhe Sistemit Statistikor të Kosovës), monitorimi i proceseve operative dhe strategjike si dhe komunikimi me përdoruesit e statistikave zyrtare paraqesin pikat kryesore në kuadër të përgjegjësisë të departamentit në fjalë.

Vendimmarrja bazuar në të dhëna është një nga qëllimet e ASK-së, prandaj sigurimi i informacioneve (të dhënave analitike) për Kryeshefin Ekzekutiv të ASK-së lidhur me performancën e departamenteve prodhuese dhe mbështetëse në ASK është një nga detyrat parësore të këtij departamenti. Në këtë kontekst, edhe gjatë vitit 2020/2021, do të ofrohen të dhëna analitike mbi performancën e proceseve prodhuese përmes të dhënave nga sistemi i SIPK-ut dhe burimeve të tjera mbi bazën e të cilave do të ofrohen informacione të nevojshme për top menaxhmentin e ASK-së.

Disa nga aktivitetet më të rëndësishme të cilat priten të realizohen nga DPPKK për vitin 2020 janë si në vijim: Hartimi i Planit vjetor të punës vjetore 2021, Monitorimi i Zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022, Zbatimi/monitorimi i aktiviteteve në kuadër të programit kombëtar të MSA-së dhe PKZMSA 2020 në fushën e statistikave, zbatimi dhe monitorimi i aktiviteteve në kuadër të planit vjetor të punës së Qeverisë (PVPQ 2020), në fushën e statistikave, zbatimi dhe koordinimi i strategjisë lidhur me agjendën SDG 2030, vazhdimi i monitorimit nga zbatimi i Planit të Veprimit për realizimin e rekomandimeve nga “Peer Review 2017”, hartimi dhe lëshimi i komunikatave nga ASK-ja me interes për shfrytëzuesit etj. Në kuadër të përgatitjeve për Regjistrimin e Popullsisë 2021, DPPKK sipas përgjegjësisë të caktuara, do të realizoj obligimet e veta.

Avancimi i një sistemi dialogues me shfrytëzuesit e të dhënave zyrtare, në mënyrë që të adresohen kërkesat e shfrytëzuesve nga pikëpamja e cilësisë dhe vëllimit të të dhënave statistikore do të jetë pjesë e proceseve rrugore të DPPKK-së gjatë vitit 2020.

3.2 Departamenti i Llogarive Kombëtare

Departamenti i Llogarive Kombëtare (DLLK) përbëhet nga dy divizione: Divizioni i Llogarive Kombëtare dhe Divizioni i Ekonomisë Joformale dhe Llogarive Qeveritare.

Lidhur me veprimet e vitit 2020, departamenti ka këto prioritete: revidimin e serive kohore të llogarive kombëtare (Bruto produktit vendor në baza vjetore, me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime aktuale dhe konstante për vitet 2008-2019) dhe Bruto produktit vendor ëbaza tremujore, me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime aktuale dhe konstante për vitet 2010-2019; shkurtimin e afatit të publikimeve; rritjen e numrit të tabelave të Bruto Produktit Vendor (BPV) për programin e transmetimit në përputhje me ESA2010; zbatimin e metodologjisë së përpilimit të Llogarive Kombëtare në baza vjetore dhe tremujore, sipas ESA 2010 dhe SNA 2008; vlerësimin e BPV në baza tremujore me çmime aktuale dhe çmime konstante sipas formatit A10 (i njëjti format sikurse ai i BPV vjetore), rregullimet sezonale (matja e efekteve sezonale) në BPV dhe efektet zinxhirore; krijimin e bazës së të dhënave SDMX (transmetimi i të dhënave duke përdorur mjetet SDMX-RI); përpilimi i llogarive sektoriale; përpilimi i llogarive kombëtare sipas tabelave ofruese-përdoruese (SUT); përpilimi i llogarive kombëtare regjionale; fillimin e publikimeve të reja; transmetimin e të dhënave në Eurostat për Llogaritë Qeveritare (shtimin e numrit të tabelave); përfshirja e rezultateve të Anketës mbi ekonominë joformale në të dhënat e BPV-së (tremujore dhe vjetore), matjen e ekonomisë joformale në aktivitete të reja dhe përfshirjen e tyre në të dhënat e BPV-së; përfundimin e detyrave të pilot-projekteve të IPA 2015 (MB) me projektet e veçanta të fushave përkatëse, asistencë teknike e FMN-së për Statistikat e Financave Qeveritare, si dhe fillimi i aktiviteteve në kuadër të Asistencës teknike me Projektin Nacional IPA për Llogaritë kombëtare dhe në kuadër të Projektit të SIDA-BE për Llogaritë Kombëtare.

Më poshtë është lista e publikimeve nga Departamenti i Llogarive Kombëtare për vitin 2020.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gush	Sht	Tet	Nën	Dhj
Llogaritë Qeveritare			TM4/2019			Vjetore 2020 TM1/2020			TM2/2020			TM3/2020
Bruto produkti vendor BVP-Qasja e Shpenzimeve & Prodhimit vjetore, revidimi i serive kohore									2008-2019			
BVP tremujore-Qasja e shpenz. dhe prodhimit				TM4/2019		TM1/2020			TM2/2020			TM3/2020

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e bijezuar paraqet muajin/vitin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Për përgatitjen e publikimeve në kuadër të Departamentit të Llogarive Kombëtare, përfshihen disa faza të punës: mbledhja e të dhënave, përfshirja, vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave, përgatitja dhe publikimi i rezultateve, ndërsa proceset rrugore janë të paraqitura në tabelën e mësipërme.

Gjatë vitit 2020 planifikohen të realizohen edhe këto aktivitete:

- Në kuadër të IPA 2017 (MB)* - Programi i bashkëpunimit statistikor shumë përfitues, gjatë vitit 2020 këto projekte të llogarive kombëtare janë në proces;
 - Statistikat e financave qeveritare (GFS/EDP);
 - Metodologjia e Llogarive Kombëtare (NAM);
 - Programi i transmetimit i të dhënave të Llogarive kombëtare vjetore, tremujore në Eurostat dhe raportimi i cilësisë;
 - Llogaritë sektoriale;
 - Llogaritë regjionale;
 - Identifikimi i burimit të të dhënave për kalkulimin e treguesve për sistemet e pa barazimeve makroekonomike;
- Projekti SUT/IOT (tabelat ofruese-përdoruese);
- Matja e ekonomisë joformale.

3.3 Departamenti i Statistikave Ekonomike

Departamenti i Statistikave Ekonomike (DSE) përbëhet nga dy divizione: divizioni i Statistikave të Çmimeve dhe Divizioni i Statistikave të Ndërmarrjeve dhe Statistikave të Tregtisë së Jashtme.

Në planin e vitit 2020, departamenti ka këto prioritete: fillimin e mbledhjes së të dhënave në mënyrë elektronike, shkurtimin e afatit të publikimit të të gjitha publikimeve (mujore, tremujore dhe vjetore); fillimin e publikimeve të reja tremujore, transmetimin e të dhënave në Eurostat (shtimin e numrit të tabelave) për statistikën e transportit, turizmit dhe energjisë; përmirësimin e cilësisë së Regjistrit të Bizneseve; përmirësimin e statistikave afatshkurtra të turizmit; përmirësimin e statistikave afatshkurtra të transportit; përmirësimin e statistikave të çmimeve; aktivitetet për kryerjen e detyrave të pilot-projektet e IPA 2017 (MB) me projektet e veçanta të fushave përkatëse. Vazhdimin e aktiviteteve në kuadër të Asistencës teknike të Projektit Nacional IPA për Statistikat ekonomike.

Më poshtë është lista e publikimeve nga Departamenti i Statistikave Ekonomike në vitin 2020.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Statistikat e tregtisë së Jashtme	Dhj 2019	Jan 2020	Shk 2020	Mar 2020	Prill 2020	Maj 2020 & 2019 vj	Qer 2020	Kor 2020	Gush 2020	Sht 2020	Tet 2020	Nën 2020
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit	Dhj 2019	Jan 2020	Shk 2020	Mar 2020	Prill 2020	Maj 2020 & 2019 vj	Qer 2020	Kor 2020	Gush 2020	Sht 2020	Tet 2020	Nën 2020
Statistikat e Hotelarisë			TM4 /2019			TM1 /2020			TM2 /2020			TM3 /2020
Indeksi i çmimit të importit			TM4 /2019			TM1 /2020			TM2 /2020			TM3 /2020
Bilanci i Energjisë në Kosovë		TM4 /2019			TM1 /2020			TM2 /2020			TM3 /2020	
Indeksi i çmimeve të prodhimit			TM4 /2019			TM1 /2020			TM2 /2020			TM3 /2020
Rep. stat mbi Ndërmarrjet në Kosovë	TM4 /2019			TM1 /2020			TM2 /2020			TM3 /2020		
Statistikat e Transportit	TM4 /2019			TM1 /2020			TM2 /2020			TM3 /2020		
Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve												2019 vj.
Indeksi i Kostos së Ndërtimit			TM4 /2019			TM1 /2020			TM2 /2020			TM3 /2020
Statistikat tremujore për Industri			TM4 /2019			TM1 /2020			TM2 /2020			TM3 /2020
Statistikat tremujore për Tregti me Pakice			TM4 /2019			TM1 /2020			TM2 /2020			TM3 /2020
Rezultatet e Anketës së PRODCOM-it												2019 vj.
Rezultatet e Anketës së (TIK) në Ndërmarrje											2019 vj.	
Rezultatet e Anketës së Investimeve në Ndërmarrje		2018 vj.										2019 vj

Vërejtje: Nëse muaji i shkruar në kutinë e bijezuar paraqet muajin/vitin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Për përgatitjen e publikimeve në kuadër të Departamentit të Statistikave Ekonomike, përfshihen disa faza të punës: zgjedhja e mostrës, anketimi/mbledhja e të dhënave, kontrolli logjik, përfshirja, përpunimi, analiza dhe publikimi i të dhënave, ndërsa proceset rrugore janë të paraqitura në tabelën e mësipërme.

Gjatë vitit 2020 planifikohen të realizohen edhe këto aktivitete, sa i përket statistikave ekonomike:

Në kuadër të IPA 2017 (MB) - Programi i bashkëpunimit statistikor me shumë përfitues IPA 2017:

- Pariteti i Fuqisë Blerëse;
- Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit;
- Regjistri Statistikor i Biznesit;

- Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve; përgatitja për FRIBS (Framework Regulation integrating business statistics);
- Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve dhe Demografisë e Ndërmarrjeve
- Statistikat e Tregtisë së Jashtme për mallra, dhe
- Statistikat për Hulimtim dhe Zhvillim - R&D (Research and Development) dhe GBAORD (Government Budget Appropriations or Outlays for Research and Development).

3.4 Departamenti i Statistikave Sociale

Ne kuadër të Departamentit të Statistikave Sociale (DSS) janë dy divizione: Divizioni i Statistikave Sociale dhe Divizioni i Statistikave të Popullsisë që janë përgjegjëse për prodhimin e statistikave sociale dhe statistikave të popullsisë.

Në programin e vitit 2020, DSS ka këto prioritetet:

- Përgatitjet për "Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave" projekt i cili pritet të zhvillohet në muajin Prill 2021. Bazuar në përvojën nga Regjistrimi i Popullsisë 2011 si dhe praktikat nga vendet e tjera, në gjysmën e parë të vitit 2020 (01-30 Prill), do të realizohet piloti i Regjistrimit të popullsisë ku do të testohen të gjitha instrumentet duke filluar nga pyetësori, pajisjet e IT, organizimi i punës në terren, trajnimi dhe tabelimi i rezultateve të regjistrimit.

Po ashtu, gjatë vitit 2020, do të finalizohen shumë dokumente strategjike përfshirë formularët/aplikacioni që ndërlidhen me për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2021.

- Hartimi i "**Regjistrimi të popullsisë**" pritet të filloi përgatitja e dokumenteve bazike nga fundi i vitit 2019 ku janë identifikuar bazat e të dhënave dhe disa module të tjera që pritet të lidhen me një bazë të dhënash në të cilën ASK duhet të ketë akses dhe supozohet të jete i disponueshem në pjesën e parë të vitit 2021 (projekti do të jete i varur nga institucionet tjera qendrore të Kosovës).
- Realizimi për herë të dytë i anketës MICS6¹ në bashkëpunim me UNICEF-in do të vazhdoje edhe në pjesën e parë të vitit 2020, ndërsa Raporti pritet të publikohet në fund të pjesës së parë të vitit 2020. Ky është raundi i gjashtë i MICS-it në nivel global, që përdorë metodologjinë ndërkombëtare të standardizuar, me qëllim të informimit të

¹ Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë

Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG). Nga MICS do të gjenerohen të dhënat për më shumë se 30 tregues të 11 Objektivave të SDG-ve

- Përmirësimin e cilësisë së të dhënave;
- Shkurtime të afatit të publikimeve;
- Implementimin e ISCED 2011;
- Implementimin e Klasifikimit Ndërkombëtar të veprave penale për qëllime statistikore;

Departamenti i Statistikave Sociale do të vazhdojë me nxjerrjen e publikimeve të rregullta sipas Kalendarit të Publikimeve 2020.

Në tabelën e më poshtme kemi pasqyruar listën e publikimeve të pritura gjatë vitit 2020:

Ne kuadër të Departamentit të Statistikave Sociale (DSS) janë dy divizione: Divizioni i Statistikave Sociale dhe Divizioni i Statistikave të Popullsisë që janë përgjegjëse për prodhimin e statistikave sociale dhe statistikave të popullsisë.

Në programin e vitit 2020, DSS ka këto prioritete:

- Përgatitjet për “Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave” projekt i cili pritet të zhvillohet në muajin Prill 2021. Bazuar në përvojën nga Regjistrimi i Popullsisë 2011 si dhe praktikat nga vendet e tjera, në gjysmën e parë të vitit 2020 (01-30 Prill), do të realizohet piloti i Regjistrimit të popullsisë ku do të testohen të gjitha instrumentet duke filluar nga pyetësori, pajisjet e IT, organizimi i punës në terren, trajnimi dhe tabelimi i rezultateve të regjistrimit.

Po ashtu, gjatë vitit 2020, do të finalizohen shumë dokumente strategjike përfshirë formularët/aplikacioni që ndërlidhen me për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2021.

- Hartimi i **“Regjistrimit të popullsisë”** pritet të filloi përgatitja e dokumenteve bazike nga fundi i vitit 2019 ku janë identifikuar bazat e të dhënave dhe disa module të tjera që pritet të lidhen me një bazë të dhënash në të cilën ASK duhet të ketë akses dhe supozohet të jete i disponueshem në pjesën e parë të vitit 2021 (projekti do të jete i varur nga institucionet tjera qendrore të Kosovës).
- Realizimi për herë të dytë i anketës MICS² në bashkëpunim me UNICEF-in do të vazhdojë edhe në pjesën e parë të vitit 2020, ndërsa Raporti pritet të publikohet në fund të pjesës së parë të vitit 2020. Ky është raundi i gjashtë i MICS-it në nivel global, që

² Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë

përdorë metodologjinë ndërkombëtare të standardizuar, me qëllim të informimit të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG). Nga MICS do të gjenerohen të dhënat për më shumë se 30 tregues të 11 Objektivave të SDG-ve

- Përmirësimin e cilësisë së të dhënave;
- Shkurtimin e afatit të publikimeve;
- Implementimin e ISCED 2011;
- Implementimin e Klasifikimit Ndërkombëtar të veprave penale për qëllime statistikore;

Departamenti i Statistikave Sociale do të vazhdojë me nxjerrjen e publikimeve të rregullta sipas Kalendarit të Publikimeve 2020.

Në tabelën e më poshtme kemi pasqyruar listën e publikimeve të pritura gjatë vitit 2020:

Muaji i botimit	Janar	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Statistikat e Mirëqenies Sociale		TM4 2019			TM1 2020			TM2 2020			TM3 2020	
Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore			TM4 2019	2019		TM1 2020			TM2 2020			TM3 2020
Niveli i pagave në Kosovë					2019							
Statistikat e Arsimit						2019/2020						
Statistikat e Lindjeve						2019						
Statistikat e Jurisprudencës për persona të mitur						2019						
Vlerësimi i popullsisë						2019						
Statistikat e Vdekjeve						2019						
Statistikat e Kurorëzimeve							2019					
Statistikat e Shkurorëzimeve							2019					
Statistikat e Jurisprudencës për personat madhor									2019			
Rezultatet e Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushitet e Jeteesë									2019			
Statistikat e Shëndetësisë										2019		
Statistikat e Kulturës										2019		
Statistikat e Sportit												2019
Gratë dhe burrat												2018/2019
Rezultatet e Anketës mbi përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (TIK)												2020
Shkaqet e Vdekjeve												2018/2019

Gjatë vitit 2020 në DSS do të realizohen aktivitetet në vijim:

1. Anketa e Fuqisë Punëtore:

- Anketimi dhe ri anketimi i ekonomive familjare të përzgjedhura në mostër janar-dhjetor 2020;
- Vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave të AFP për TM4 2019;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të AFP-së për TM4 2019, mars 2020;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të AFP-së për vitin 2020 (publikimi vjetor), prill 2020;
- Vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave për TM1 2020, prill, maj, qershor 2019;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të AFP-së për TM1 2020, qershor 2020;
- Vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave për TM2 2020 ,korrik, gusht, shtator 2020;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të AFP-së për TM2 2020, tetor 2020;
- Vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave për TM3 2020 ,korrik, gusht, shtator 2020;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të AFP-së për TM3 2020, dhjetor 2020;

2. Niveli i pagave në Kosovë 2019

- Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i të dhënave, prill-gusht 2020;
- Publikimi i të dhënave, shtator 2020;

3. Anketa mbi përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (TIK)

- Grumbullimi i të dhënave të TIK 2020, prill, maj 2020;
- Vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave, qershor-shtator 2020;
- Transmetimi i të dhënave të TIK në Eurostat, tetor 2020;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të TIK 2020, dhjetor 2020.

1. Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC)

- Pastrimi i bazës së të dhënave të anketës SILC 2019, janar-qershor 2020;
- Grumbullimi i të dhënave në teren për anketën SILC 2020, maj- qershor 2020;
- Analizimi, përgatitja e të dhënave për transmetim në Eurostat dhe prodhimi i indikatorëve të SILC 2019, mars-shtator 2020;
- Transmetimi i të dhënave (SILC 2019) në Eurostat, shtator 2020;
- Publikimi i rezultateve të SILC 2019, shtator 2020;

5. Statistikat e jurisprudencës për personat e mitur

- Grumbullimi i të dhënave për TM4 2019, janar 2020;
- Grumbullimi i të dhënave për TM1, TM2 dhe TM3 2020,prill-dhjetor 2020;
- Kontrollimi logjik, përpunimi dhe analizimi i të dhënave për vitin 2019, janar-maj 2020;
- Publikimi i rezultateve të statistikave të jurisprudencës për personat e mitur 2019, qershor 2020.

6. Statistikat e jurisprudencës për persona madhor

- Grumbullimi i të dhënave për TM4 2019, janar 2020;
- Grumbullimi i të dhënave për TM1, TM2 dhe TM3 2019 ,prill-dhjetor 2020;
- Kontrollimi logjik, përpunimi dhe analizimi i të dhënave për vitin 2019, janar-korrik 2020;
- Publikimi i rezultateve të statistikave të jurisprudencës për personat madhor 2019, shtator 2020.

7. Statistikat e arsimit

- Grumbullimi i të dhënave të arsimit 2019/2020 , janar-shkurt 2020;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave mars –qershor 2020;
- Publikimi i të dhënave, qershor 2020.

8. Statistikat e mirëqenies sociale

- Grumbullimi i të dhënave për TM4 2019, janar 2020;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave të mirëqenies sociale për TM4 2019, shkurt 2020;
- Publikimi i dhënave për TM4 2019 shkurt 2020
- Grumbullimi i të dhënave për TM1 2020, prill 2020;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave të mirëqenies sociale për TM1 2020 prill, maj 2020;
- Publikimi i dhënave për TM12020, maj 2020
- Grumbullimi i të dhënave për TM2 2020, korrik 2020;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave të mirëqenies sociale për TM2 2020, korrik, gusht 2020;
- Publikimi i dhënave për TM2 2020, gusht 2020;
- Grumbullimi i të dhënave për TM3 2020, tetor 2020;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave të mirëqenies sociale për TM3 2020, tetor, nëntor 2020;
- Publikimi i dhënave për TM3 2020, nëntor 2020.

9. Statistikat e Shëndetësisë

- Grumbullimi i të dhënave të shëndetësisë 2019, shkurt-prill 2020;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave, qershor-shtator 2020;
- Publikimi i të dhënave të shëndetësisë 2019, tetor 2020.

10. Statistikat e Kulturës dhe Sportit

- Grumbullimi i të dhënave të Kulturës 2019 , prill-maj 2020;
- Kontrollimi logjik, përpunimi dhe analizimi i të dhënave, qershor-shtator 2020;
- Publikimi i të dhënave të Kulturës 2019, tetor 2020;
- Grumbullimi i të dhënave të Sportit 2019 , maj-qershor 2020;
- Kontrollimi logjik, përpunimi dhe analizimi i të dhënave, korrik-nëntor 2020;
- Publikimi i të dhënave të Sportit 2019, dhjetor 2020.

11. Statistikat Vitale 2019 (lindjet, vdekjet, kurorëzimet, shkurorëzimet)

- Grumbullimi i të dhënave për statistikat vitale (lindjet, vdekjet, kurorëzimet, shkurorëzimet) çdo muaj, janar – dhjetor 2020;
- Përfshirja në data bazë, kontrolli logjike, përpunimi, analiza e të dhënave të statistikave vitale (lindjet, vdekjet, kurorëzimet, shkurorëzimet);
- Publikim i të dhënave vjetore mbi: lindjet dhe vdekjet (qershor 2020);
- Publikim i të dhënave vjetore statistikave kurorëzimeve dhe statistikave shkurorëzimeve (korrik 2020).

12. Vlerësimi i popullsisë 2019

- Grumbullimi i të dhënave për lindjet dhe vdekjet;
- Grumbullimi i të dhënave për imigrimet dhe emigrimet;
- Kontrolli logjik, përpunimi dhe analiza e të dhënave;
- Publikimi i të dhënave, qershor 2020.

13. Statistikat mbi shkaqet e vdekjeve në Kosovë për vitin 2018 - 2019

- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave mbi shkakun e vdekjes;
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare;
- Publikimi i të dhënave, dhjetor 2020.

14. Gratë dhe Burrat në Kosovë, për vitin 2018-2019

- Grumbullimi i të dhënave brenda ASK-së në baza gjinore ;
- Grumbullimi i të dhënave në baza gjinore nga Ministrinë dhe institucionet tjera;

- Kontrolli logjik, përpunimi dhe analiza e të dhënave;
- Publikimi i të dhënave, dhjetor 2020.

15. Aktivitetet tjera:

- Zhvillimi i pilot Anketës së Kostos së Punës
- Zhvillimi i pilot Anketës për “Vendet e lira të punës”;
- Zhvillimi i para testimit dhe pilot anketës Dhuna në baza gjinore në kuadër të projekti IPA 2017.

3.5 Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit (DSBM) përbëhet nga dy Divizione: Divizioni i Statistikave të Bujqësisë dhe Divizioni i Statistikave të Mjedisit.

DSBM është përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e statistikave zyrtare, të besueshme dhe me kohë për bujqësi, pylltari, statistika agro-monetare dhe të mjedisit, si dhe standardizimin e prodhimit të këtyre statistikave me BE-në.

Më poshtë është lista e publikimeve nga Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në vitin 2020.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi (vjetor)		(2015-2019 Vjetore)										
Indeksi i Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi (Vjetor)		(2015-2019 Vjetore)										
Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi (Tremujor)		TM4/ 2019			TM1/ 2020			TM2/ 2020			TM3/ 2020	
Indeksi i Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi (Tremujor)		TM4/ 2019			TM1/ 2020			TM2/ 2020			TM3/ 2020	
Statistikat e Ujërave në Kosovë 2018-2019			2018 - 2019, Çdo dy vite									
Gazrat Serrë (Llogaritjet e Emisioneve të Aritit) 2018 - 2019									2018 -2019, Çdo dy vite			
Anketa e Ekonomive Bujqësore 2018 (vjetore)									2019			
Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi 2018 (Vjetore)									2019			
Anketa e Mbeturinave të Trajtuara 2019 (vjetore)										2019		
Anketa e Mbeturinave Komunale 2019 (vjetore)											2019	
Anketa e Mbeturinave Industriale 2019 (vjetore)												2019

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin, në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Për përgatitjen e publikimeve në kuadër të Departamentit të Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, përfshihen disa faza të punës: përgatitja e mostrës, anketimi i ekonomive bujqësore/mbledhja e të dhënave administrative, përfshirja, kontrolli logjik, përpunimi dhe analiza e të dhënave, përgatitja dhe publikimi i rezultateve, ndërsa proceset rrugore janë të paraqitura në tabelën e mësipërme.

Gjatë vitit 2020 planifikohen të realizohen edhe këto aktivitete:

- Realizimi i pilot-projekteve në kuadër të IPA 2017:
 - Statistikat e Bujqësisë (Kulturave bujqësore, bimore, vjetore, Pemët, Vreshtat, statistikat e prodhimitarisë blegtorale dhe statistikat agromonetare);
 - Llogaritjet mjedisore

3.6 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative

Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative përbehet nga dy Divizione: Divizioni i Metodologjisë dhe Shpërndarjes dhe Divizioni i Teknologjisë Informative.

Në Divizionin e Metodologjisë dhe Shpërndarjes për vitin 2020 planifikohen këto aktivitete.:

- Nxjerrjen e mostrave për të gjitha anketat e parashtruara nga statistikat prodhuese si dhe të hulumtimeve tjera në ASK,
- Nxjerrja e Mostrës për Anketën e Fuqisë Punëtore si dhe Anketën e Ekonomive familjare Bujqësore;
- Nxjerrja e Mostrës për anketën “SILC (Survey on Income and Living Conditions)”
- Nxjerrja e Mostrës për anketën “ICT (Information & Communication Technology Survey)”
- Nxjerrja e Mostrës për Anketën e Turizmit;
- Nxjerrja e Mostrës për Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare;
- Nxjerrja e Mostrave edhe për Hulumtime tjera shtesë të cilat mundë të kërkohen nga Institucionet e ndryshme ndërkombëtare apo edhe ato vendore;
- Llogaritja e Peshave për Hulumtimet dhe Anketat e lartcekura;
- Rivlerësimi i peshave për hulumtimet e ndryshme statistikore;
- Vazhdimi i projektit për Metadata;
- Menaxhimi dhe përmirësimi i Cilësisë statistikore,
- Realizimi i Anketës së Kënaqshmërisë së Stafit;

- Ngritja e kapaciteteve profesionale, dokumentimi i metadatave sipas ESMS dhe ESQRS;
- Dokumentimi i të gjitha metodologjive dhe vlerësimet e tyre;
- Do të vazhdohet me përllogaritjen dhe vlerësimin e gabimeve në mostër për të gjitha anketat tjera statistikore;
- Angazhimi në përgatitjet për regjistrimin e popullsisë 2021 (Pilot Testi dhe anketa PES);
- Angazhimi në anketën MICS;
- Sektori Shpërndarjes do të vazhdojnë të punojë dhe t'i mbështesë departamentet prodhuese, lidhur me kontrollimin dhe përgatitjen e të gjitha publikimeve statistikore, duke zbatuar standardet e Eurostatit, si dhe duke përfshirë këtu edhe shenjzimin e numrit standard të ISBN-së për të gjitha publikimet vjetore të statistikave.
- Kalendarit të Publikimeve 2020 do të jetë instrument shumë i rëndësishëm, që sektori i shpërndarjes-desiminimit përgatit dhe bën kontrollimin dhe verifikimin në SIPK programin të afateve kohore të publikimeve, në bazë të deklaratimit të datave për publikimin e tyre nga përgjegjësit e departamenteve prodhuese të ASK-së.
- Informimi i shfrytëzuesve për arsyen dhe vonesën e publikimeve është një informatë shtesë ku me këtë lloj informate shfrytëzuesit e të dhënave janë të informuar me kohë lidhur me datën se kurë do të publikohen të dhënat të cilat nuk janë publikuar në afatet e caktuara kohore sipas Kalendarit të Publikimeve.
- Përkthimi i të gjitha publikimeve dhe dokumenteve zyrtare nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe angleze do të jetë punë e këtij sektori edhe gjatë vitit 2020.
- Shpërndarja e publikimeve statistikore, në mënyrë elektronike në adresat e shfrytëzuesve.
- Vazhdimi i publikimeve horizontale tremujore dhe vjetore, të cilat janë si rezultat i statistikave prodhuese do të jenë proces në vazhdimësi për prezantimin e të dhënave kyçe për shfrytëzuesit dhe përdoruesit.
- Vjetari Statistikor i ASK-së, i cili planifikohet të përgatitet gjatë muajve të parë të Vitit 2020.
- Katalogu i Publikimeve 2019,
- Kosova në Shifra 2019,
- Buletini Tremujor TM4 2019, TM1 2020, TM2 2020 dhe TM3 2020,

Në tabelën e më poshtme janë dhënë disa procese rrugore të disa publikimeve.

Muaji i botimit	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Vjetari Statistikor						2020						
Kosova në Shifra									2020			
Buletini tremujor	TM4 2019			TM1 2020			TM2 2020			TM3 2020		
Fletëpalosja e ASK-së												2019
Kalendari i publikimeve të ASK-së											2021	
Kalendari vjetor i ASK-së												2021
Katalogu i publikimeve të ASK-së			2019									

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin në të cilin publikimet priten të shpërndahen

Në fushën e Teknologjisë Informative TI-së, prioritet për vitin 2020 do të jetë Regjistrimi i Popullsisë 2021. Do të zhvillohet infrastruktura e TI-së për të ndihmuar në të gjitha fazat e Regjistrimit të Popullsisë, veçanërisht teknologjitë e reja që mund të përdoren për aktivitetet e mbledhjes, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave.

Do të vazhdohet me digjitalizimin e të dhënave edhe për anketat tjera përmes përdorimit të sistemeve të avancuara për mbledhjen e të dhënave nga terreni, metoda CAPI (Intervistë Personale me Ndihmën e Kompjuterit) dhe CAWI ((Intervistë Personale Përmes Ueb Aplikacionit)).

Do të ketë fuqizim të mëtejme të sistemit të GIS-it për menaxhimin e të dhënave gjeo-hapësinore si dhe përdorimi i tyre për zhvillimin e anketave të ndryshme në terren.

Do të promovohet platforma ASKdata edhe në institucione tjera qeveritare me qëllim që ky sistem të jetë si platformë unike për shpërndarjen por edhe për shkëmbimin e të dhënave.

Zhvillimi i mëtejme i ueb faqes së re në platformën ASP.NET do të vazhdojë, ku parashihet lidhja me ueb aplikacione, shpërndarja e metadatave sipas standardeve të Eurostat-it, formati ESMS si dhe zhvillimi i veglave për vizualizim dhe krijimin e Infografeve.

Zbatimi dhe integrimi i SharePoint në ASK, si dhe zhvillimi i mëtejme i Sistemit të Përfshirjes së Kohës (SIPK) do të vazhdojë edhe në vitin 2020.

Do vazhdohet mbështetja e departamenteve prodhuese në transmetimin e të dhënave sipas standardeve të Eurostat-it, sistemi eDAMIS.

3.7 Departamenti i Anketimeve dhe Regjistrimeve

Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve (DRA) është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave statistikore përmes raporteve dhe anketave të planifikuara nga departamentet prodhuese të ASK-së. Ky departament sfidë në vazhdimësi do të ketë ngritjen e cilësisë së mbledhje së të dhënave sipas kriterëve dhe standardeve, shkurtimin e kohës me qëllim të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit gjatë mbledhjes së të dhënave .

DAR ka nën menaxhimin e vet shtatë (7) Zyrat Rajonale të ASK-së. DRA bënë menaxhimin, mbikëqyrjes dhe kontrollin e punëve dhe aktiviteteve operative të Zyrave Rajonale të ASK-së lidhur me mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave në terren.

DAR gjatë periudhës 2018 -2022 ka filluar me mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave me mjete dhe pajisje të TI-së, ku si mjete përdoren Tabletat dhe ku të dhënat gjatë anketimeve shkarkohen direkt në bazat e veçanta të Serverëve të ASK-së. Qëllimi kryesor është zhvillimi i praktikave dhe standardeve të avancuara, si dhe ngritja e cilësisë së të dhënave, duke bërë shkurtimin e kohës së grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave për departamentet prodhuese. Gjatë vitit 2020 është planifikuar që shumica e hulumtimeve të realizohen me metodën CAPI.

DRA në vitin 2020 në bashkëpunim me departamentet prodhues dhe tjera do të shtojë monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e punëve dhe aktiviteteve gjatë realizimit të mbledhjes, grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave me qëllim të rritjes së sasisë dhe cilësisë së të dhënave te cilat ndikojnë në prodhimin e statistikave të besueshme të ASK-së për institucione vendore, ndërkombëtare dhe përdorues të tjerë.

Për realizimin e punëve dhe aktiviteteve në bazë të dinamikës së Planit dhe Programit të ASK-së për vitin 2020 , DRA do t'i përgatisë raportet praktike ditore, javore, mujore dhe vjetore mbi ecurinë në realizimin detyrave dhe zhvillimin e aktiviteteve në bazë të afateve të planifikuara për vitin 2020.

3.8 Departamenti i Administratës

Departamenti i Administratës është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative ditore në ASK, si: operacione financiare, kontabilitet, prokurim, rekrutime, gjegjësisht procedura, administrim i personelit (vijueshmëria në punë, largime, dosje personale, etj.), furnizime, logjistikë, etj. Edhe gjatë vitit 2020 do të bëjë përgatitjen e pasqyrave financiare, raporteve mujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore; shërbime të personelit, duke mbuluar mirëqenien, rekrutimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore; prokurimin dhe shërbimet për menaxhimin e kontratave (menaxhimi i aseteve, pronës dhe shërbimet e logjistikës). Në kuadër të Departamentit të Administratës janë të angazhuar një drejtor dhe 12 zyrtarë për vitin 2020.

Një prej pikave kyçe do të jetë zbatimi i Planit të Vjetor 2020, si dhe respektimi i të gjitha procedurave, gjegjësisht legjislacionit në fuqi, në funksion të menaxhimit të aktiviteteve të lartcekura.

4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORËT

Ndihma e donatorëve ka dhënë vazhdimisht ndikim në ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe në përmirësimin e produkteve statistikore të ofruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, për institucionet dhe përdoruesit e statistikave në tërësi.

Në kuadër të mbështetjes nga donatorët, ASK-ja ka bashkëpunim të vazhdueshëm me EU, SIDA/SCB, FMN, UNFPA, UNICEF, UNDP, etj. Prandaj fushat e bashkëpunimit do të jenë:

- Ngritja e kapaciteteve dhe ndihma në fushën e projekteve do të jetë e vazhdueshme dhe me shumë interes për ASK-në. Gjatë vitit 2020, donatorët do të vazhdojnë ta mbështesin stafin në ngritjen e kapaciteteve në shumë aktivitete të ndryshme, me numër të konsiderueshëm pjesëmarrjeje në të gjithë sektorët e statistikave. Vazhdimi i mbështetjes së stafit të ASK-së për pjesëmarrje në takime, konferenca, trajnime, takime pune, grupe të punës, që janë të planifikuara në instrumentin planifikues të aktiviteteve, MC-listë dhe nga Katalogu i takimeve “European Statistical Training Programe ESTP” mbështetur nga Eurostat-i dhe organizatat e tjera për vitin 2020.
- Koordinimi i aktiviteteve në baza mujore, për takimet e stafit të ASK-së, realizimi i takimeve, aprovimet dhe raportet e aktivitetit, etj.

Komisioni Evropian përmes Programit IPA 2017 (i planifikuar për periudhën dy vjeçare), gjatë vitit 2020-2021 do të vazhdojë ta mbështesë ASK-në me 24 pilot-projekte:

Pilot-projektet IPA 2017 periudha implementuese 2019-2021

1	Government Finance and Excessive Deficit Statistics
2	International trade in services statistics (ITSS)
3	National Accounts - Methodology
4	Transmission programme, annual national accounts (ANA), quarterly national accounts (QNA)
5	Regional accounts
6	Sector Accounts
7	Supply, use and input-output tables (SUT/IOT)
8	HICP and HPI
9	Price statistics - PPP
10	Business Registers
11	Short-term business statistics: preparation for FRIBS

12	Structural business statistics (SBS) and business demography statistics (BD)
13	International Trade in Goods Statistics (ITGS)
14	Research & Development (R&D) statistics and GBAORD statistics
15	Labour force survey (LFS)
16	EU-SILC implementation
17	Crime and Criminal Justice Statistics
18	Survey on gender based violence (GBV)
29	Agricultural statistics
20	Environmental accounts
21	Quality management
22	Implementing standards for metadata and data exchange
23	Source (basic) data required for the calculation of the macroeconomic imbalances procedure (MIP)
24	Reporting on horizontal activities

- Do të vazhdohet me aktivitetet rreth realizimit të pilote projekteve duke koordinuar aktivite si: ToR, kontrata, fatura, raportet dhe të të gjitha aspekteve tjera koordinuese që dalin gjatë implementimit të programit IPA në realizimin e plotë për secilin Pilot projekt.
- Koordinimi i aktivitetëve me departamentet në kuadër të dërgimit të të dhënave vjetore në Eurostat për treguesit e shumtë statistikorë. Dy runde brenda vitit “Mbledhja e të dhënave”.
- Koordinimi i aktivitetëve me departamentet dhe BQK-ne në kuadër të mbledhjes dhe plotësimit të të dhënave në nivel modular për SMIS+ në baza vjetore.
- Vazhdimi bashkëpunimit me donatorët dhe koordinimi i aktivitetëve në kuadër të projekteve të mbështetura nga donatorët.
- Bashkëpunimi me departamentet dhe realizimi në kohë i proceseve statistikore.
- Koordinimi i proceseve statistikore me vendet e BE-së dhe të rajonit, harmonizimi i tyre në kuadër të Strategjisë 2014-2020.

Gjithashtu ASK-ja ka një mbështetje të lartë nga donatorë të ndryshëm në përmirësimin e proceseve të produkteve statistikore. Tabela me poshtë tregon emrin e projekteve në zbatim, si dhe emrin e mbështetjes nga donatorët:

Projektet e mbështetura nga Donatorët, që janë në proces të zhvillimit dhe ato që vazhdojnë në vitin 2018	Donatorët:
Statistikat në vendimarrje	Banka Botërore
Mbështetje e Sistemit Statistikor të Kosovës	Zyra e BE-së dhe Swedish International Development Agency (SIDA)
IPA 2015 – Programi Shumëpërfitues i Bashkëpunimit Statistikor (ngritja profesionale e stafit , trajnimet afatëgjata, takime pune, vizitat studimore, kurset e trajnimit etj).	Eurostati

5. SFIDAT

Sfidat me të cilat pritet të ballafaqohet ASK-ja janë:

- Zbatimi i Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022 (PSZ);
- Zbatimi i Planit Kombëtar për MSA-në, në fushën e statistikave;
- Sigurimi i indikatorëve, gjegjësisht monitorimi i strategjisë SEE 2020 dhe SDG;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i të dhënave statistikore;
- Krijimi i një sistemi unik statistikor të TI-së;
- Zbatimin e Kornizës së Vlerësimit të Performancës së PVSZ (për disa indikatorë);
- Kuadri i burimit të të dhënave, ende i pamjaftueshëm
- Harmonizimi i statistikave ndërmjet ASK-së dhe ministrive, që janë prodhuese të statistikave;
- Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e Projektit të Regjistrimit të Popullsisë 2021.
- Implementimi i pilot-projekteve IPA 2017 dhe projektet me donatore tjerë.

6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE DHE QASJA

- Azhurnimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i platformës për shpërndarjen e bazës së shënimeve ASKData do të vazhdojë, pasi objektivi i ASK-së është që edhe gjatë vitit 2020, ASKData të jetë kanali kryesor i shpërndarjes së të dhënave.
- Ofrimi i të dhënave statistikore në ueb-faqen e ASK-së në formatin PDF, Excel për të gjitha departamentet statistikore.

KALENDARI PUBLIKIMEVE

2020

DATA E PUBLIKIMIT	TITULLI I PUBLIKIMIT	PERIUDHA
JANAR		
10 janar 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Dhjetor 2019)
24 janar 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Dhjetor 2019)
30 janar 2020	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	(TM4-2019)
30 janar 2020	Statistikat e Transportit	(TM4 - 2019)
31 janar 2020	Buletini Tremujor	(TM4 - 2019)
SHKURT		

07 shkurt 2020	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM4/2019
13 shkurt 2020	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM4/2019
14 shkurt 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Janar 2020)
15 shkurt 2020	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM4/2019
21 shkurt 2020	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	(2015-2019)
27 shkurt 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(janar 2020)
27 shkurt 2020	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	(2015-2019)
28 shkurt 2020	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM4/2019
28 shkurt 2020	Statistikat e Investimeve	2018
MARS		
04 mars 2020	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM4/2019
05 mars 2020	Statistikat e Hotelerisë	TM4/2019
06 mars 2020	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM4/2019
06 mars 2020	Llogaritë Qeveritare	TM4/2019
11 mars 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Shkurt 2020)
11 mars 2020	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM4/2019
13 mars 2020	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM4/2019
16 mars 2020	Katalogu i publikimeve,	2019
17 mars 2020	Statistikat Afatshkurtra të Tregëtisë me Pakicë	TM4/2019
19 mars 2020	Anketa së Fuqisë Punëtore	TM4/2019
20 mars 2020	Statistikat e Ujërave në Kosovë	2018/2019
23 mars 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Shkurt 2020)
PRILL		
02 prill 2020	Anketa së Fuqisë Punëtore	2019
03 prill 2020	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	TM4/2019
10 prill 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Mars 2020)
15 prill 2020	Niveli i Pagave	2019
23 prill 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Mars 2020)
30 prill 2020	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	TM1/2020
30 prill 2020	Statistikat e Transportit	TM1/2020
30 prill 2020	Buletini Tremujor	TM1/2020
MAJ		
08 maj 2020	Indeksi i Çmim. të Prodhimeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM1/2020
12 maj 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Prill 2020)
14 maj 2020	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM1/2020
15 maj 2020	Indeksit Çmimeve të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM1/2020
20 maj 2020	Statistikat e Mirëqenjes Sociale	TM1/2020
22 maj 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Prill 2020)
29 maj 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	2019

29 maj 2020	Niveli i Pagave	2019
QERSHOR		
01 qershor 2020	Llogaritë Qeveritare	2019
03 qershor 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	2019
03 qershor 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	2019
03 qershor 2020	Indeksi i Çmimve të importit	TM1/2020
04 qershor 2020	Statistikat e Hotelarisë	TM1/2020
05 qershor 2020	Llogaritë Qeveritare	TM1/2020
05 qershor 2020	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM1/2020
05 qershor 2020	Anketa e Ekonomive Bujqësore	2019
10 qershor 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Maj 2020)
10 qershor 2020	Indeksi i Kosotos së Ndërtimit	TM1/2020
12 qershor 2020	Statistikat e Arsimit	2019/2020
12 qershor 2020	Statistikat e Lindjeve në Kosovë	2019
12 qershor 2020	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM1/2020
16 qershor 2020	Statistikat Afatshkurtëra të Tregtisë me pakicë	TM1/2020
18 qershor 2020	Anketa e Fuqisë Punëtore	TM1/2020
24 qershor 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Maj 2020)
25 qershor 2020	Statistikat e Vdekjeve	2019
26 qershor 2020	Bilanci i Energjisë në Kosovë	2019
26 qershor 2020	Statistikat e Jurisprudencës për Persona të Mitur	2019
26 qershor 2020	BPV me Qasjen e Shpenzimeve dhe Prodhimit TM1-2019	TM1/2020
26 qershor 2020	Vlerësimi i Popullsisë	2019
30 qershor 2020	Vjetari Statistikor	2020
KORRIK		
10 korrik 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Qershor 2020)
10 korrik 2020	Statistikat e Kurorëzimeve në Kosovë	2019
24 korrik 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Qershor 2020)
24 korrik 2020	Statistikat e Shkurorëzimeve në Kosovë	2019
31 korrik 2020	Statistikat e Transportit	TM2/2020
31 korrik 2020	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	TM2/2020
31 korrik 2020	Buletini Tremujor	TM2/2020
GUSHT		
04 gusht 2020	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM2/2020
07 gusht 2020	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM2/2020
11 gusht 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Korrik 2020)
14 gusht 2020	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM2/2020
20 gusht 2020	Statistikat e Mirëqenjes Sociale	TM2/2020
21 gusht 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Korrik 2020)
SHTATOR		

02 shtator 2020	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM2/2020
03 shtator 2020	Statistikat e Hotelerisë	TM2/2020
03 shtator 2020	Statistikat e Jurisprudencës për Persona Madhor	2019
04 shtator 2020	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM2/2020
04 shtator 2020	Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi	2019
04 shtator 2020	Llogaritë Qeveritare	TM2/2020
09 shtator 2020	Indeksi i Kostos së Ndertimit	TM2/2020
11 shtator 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Gusht 2020)
11 shtator 2020	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM2/2020
15 shtator 2020	Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë	TM2/2020
17 shtator 2020	Anketa e Fuqisë Punëtore	TM2/2020
18 shtator 2020	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	2019
21 shtator 2020	Kosova në shifra	2019
22 shtator 2020	Gazrat Serrë (Llogaritjet e Emisioneve të Ajrit)	2018/2019
23 shtator 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Gusht 2020)
30 shtator 2020	Rezultatet e Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës	2019
30 shtator 2020	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	TM2/2020
TETOR		
02 tetor 2020	Statistikat e Shëndetësisë	2019
12 tetor 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Shtator 2020)
16 tetor 2020	Statistikat e Kulturës	2019
23 tetor 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Shtator 2020)
23 tetor 2020	Anketa e Mbeturinave të Trajtuara	2019
30 tetor 2020	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	TM3/2020
30 tetor 2020	Statistikat e Transportit	TM3/2020
30 tetor 2020	Buletini Tremujor	TM3/2020
NËNTOR		
06 nëntor 2020	Indeksi i Çmim. të Prodhimeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM3/2020
11 nëntor 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Tetor 2020)
13 nëntor 2020	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM3/2020
13 nëntor 2020	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM3/2020
20 nëntor 2020	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM3/2020
20 nëntor 2020	Anketa e Mbeturinave Komunale	2019
20 nëntor 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Tetor 2019)
25 nëntor 2020	Kalendari i Botimeve të ASK-së	2021
DHJETOR		
01 dhjetor 2020	Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve	2019
03 dhjetor 2020	Rezultatet e Anketës së PRODCOM	2019
03 dhjetor 2020	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM3/2020

04 dhjetor 2020	Statistikat e Hotelerisë	TM3/2020
04 dhjetor 2020	Llogaritë Qeveritare	TM3/2020
07 dhjetor 2020	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM3/2020
09 dhjetor 2020	Statistikat e Sportit	2019
10 dhjetor 2020	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM3/2020
11 dhjetor 2020	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Nëntor 2020)
11 dhjetor 2020	Gratë dhe Burrat	2018/2019
15 dhjetor 2020	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM3/2020
15 dhjetor 2020	Fletëpalosja e ASK-ës	
16 dhjetor 2020	Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë	TM3/2020
16 dhjetor 2020	Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit	2020
17 dhjetor 2020	Anketa e Fuqisë Punëtore	TM3/2020
18 dhjetor 2020	Statistikat e Investimeve	2019
22 dhjetor 2020	Shkaqet e Vdekjeve	2018/2019
22 dhjetor 2020	Anketa e Mbeturinave Industriale	2019
23 dhjetor 2020	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Nëntor 2020)
24 dhjetor 2020	BPV me Qasjen e Shpenzimeve dhe Prodhimit	TM3/2020)
30 dhjetor 2020	Anketa e TIK-ut në Biznese	2019

7. BUXHETI

Për periudhën e përmendur të Hartës Rrugore 2020, buxheti për ASK-së është si në vijim:

Buxheti për ASK 2020

Buxheti 2020	€
	MF *
Pagat & Mëditje	1,094,936.85
Mallrat dhe Shërbimet	3,722,623.00
Shpenzimet kosto	21,875.00
TOTAL:	4,839,434.85
Numri i punëtorëve	169

*Shënim:

- Buxheti në vlerë 4,839,434.85 € është nga buxheti i Kosovës i aprovuar nga MF.
- Në kategorinë mallra dhe shërbime është i përfshirë edhe buxheti për përgatitjet e Regjistrimit të Popullsisë 3,299,663.00 €.

Aneksi 1 - Organogrami i ASK-së



